



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:082290

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04881208

P.nr.1750/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarës Z. K. nga Obiliqi, e akuzuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.2498/2023 të datës 27.04.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 27.10.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Arben Hoti, e akuzuara Z. K. dhe mbrojtësi sipas autorizimit av. Xhevat Balaj, me datë 30.10.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

Z. K., e bija e A. dhe nëna M, e gjinisë J, e lindur me ..., në G. KK D., me vendbanim në Rr. “M. A.” M. KK O., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e larte pedagogjike, e ve, nene e katër fëmijëve, e punësuar mësimdhënëse, e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Se nga viti 2015 e deri me datë 25.12.2021, në rrugën “M. A.”, në K. e O., përkatësisht në shtëpinë e saj, e pandehura me dashje dhe vetëdije e në kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 lidhur me nenin 4 të Ligjit 05/L-022 për Armët, pa autorizim, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë zjarri dhe municion dhe atë një (1) armë zjarri e llojit G.-B., me gazë kalibri 9mm, prodhim Italian si dhe dy (2) fishek me gazë kalibri 9mm dhe një karikator, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli nga ana e zyrtarëve policor në shtëpinë e të pandehurës, i është gjetur arma dhe municioni i cekur të cilat janë sekuestruar nga Policia.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 366 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, të akuzuarës Z. K., Gjykata i shqipton dënim me gjobë në vlerë prej 100.00 Euro (njëqind) Euro, të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Obligohet e pandehura që konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, dënimin e lartëcekur ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse e pandehura nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.
- III.** Gjykata në mbështetje të nenit 277 par.1 të KPPRK-së si dhe nenit 366 par.3 të KPRK-së, URDHËRON konfiskimin e përhershëm të armës G.-B. me gazë Calibri 9 mm, prodhim Italian si dhe dy (2) fishek me gazë 9 mm dhe një karikator dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi urdhërohet shkatërrimi i saj nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.
- IV.** Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.2498/2023 të datës 27.04.2023, ndaj të akuzuarës Z. K. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.10.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Arben Hoti, të akuzuarës Z. K. dhe mbrojtësit të saj sipas autorizimit av. Xhevat Balaj, ku e akuzuara pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, ndërsa mbrojtësi i saj ka deklaruar se është fakt që arma që është cek ne aktakuzë është gjetur në shtëpinë e të akuzuarës ka qenë armë me gaz është blerë nga tani i ndjeri bashkëshorti i të akuzuarës siç ka deklaruar e akuzuara edhe ne fazën e procedurës së akuzës, kjo armë është blerë për qëllim të frikësimit të disa hajnave që i kanë thyer shtëpinë disa here, nuk është blerë me qëllim të shkaktohet dëm. E akuzuara pas vdekjes së bashkëshortit armen e ka fshehur që mos te kenë qasje anëtarët tjerë të familjes por me rastin e bastisjes nga policia e Kosovës kjo armë është gjetur dhe është sekuestruar siç thamë edhe më herët armë me gaz. Kërkojmë nga gjykata që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë si ne vijim: ka qene arme me gazë, e akuzuara është e gjendjes së varfër ekonomike, edhe pse është

mësuese me rrogën e saj mban anëtarët e familjes, nuk është shkaktuar ndonjë dëm nga arma, është hera pare që ka rënë ne kundërshtim me ligjin, ta ketë parasysh si rrethanë tejet lehtësuese edhe pranimin e fajësisë dhe të shqiptohet një dënim minimal siç e parasheh ligji.

Pas deklarimit të akuzuarës, mendimit te prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga e pandehura pasi që një pranim i tillë bëhet ne mënyrë vullnetare, e pandehura është i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar si ne aktakuzë. Gjykata konstatoj se e akuzuara e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, e akuzuara është e vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, , si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarës.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarës se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AJ-443 i datës 25.12.2021; Raporti i Policit G. J. #..., i datës 25.12.2021; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurën Z. K., i datës 14.04.2023, dhënë në Prokurorin Themelore në Prishtinë; Lista e armëve të konfiskuara, i datës 25.12.2021 si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarës Z. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e akuzuara e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarën, gjykata ka vlerësuar faktin se e njëjta më parë kishte sjellje korrekte dhe se nuk kishte të kaluar kriminale. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën qe e ka kryer, po ashtu e njëjta ka moshë të shtyrë. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarës, ndërsa si rrethanë renduese gjykata ka vlerësuar dashjen.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 48 te KPRK-se te akuzuarën e gjykoi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarës është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te saj dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtte të veprës penale, por ajo do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se. Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, gjykata ndaj të akuzuarës ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armëve të përshkruara më lartë.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1750/23 më datë 06.11.2023**

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjyquese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.